



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 19/2015

Prishtinë, më 19.5.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca, Fatmir Rexhepi, Pal Lekaj dhe Enver Hoti - anëtarë.

Mungoi: Duda Balje, anëtare.

Pjesëmarrës të ftuar: Musa Shabani, kryesues i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM.

Pjesëmarrës të tjerë: Ramiz Krasniqi, Azem Rexhaj, Festim Kutllavci dhe Midin Bojaxhiu – KPMM; Avni Jashari dhe Arben Limani – AKP; Lejla Selimi-OSBE; Zanë Hoxha – INDEP; Bleta Gashi- Rrokum TV; Pranvera Musa – Kosova- Press; Besa Berisha dhe Arta Xhylani – UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28.04.2015 dhe 05.05.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i peticionit të Sindikatës së hotelit “Grand” bazuar në Përfundimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, të datës 22.04.2015;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28.04.2015 dhe 05.05.2015

Procesverbalet nga mbledhja e mbajtur më 28.4.2015 dhe 05.05.2015, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2014

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa – Sot kemi të ftuar përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM, për të prezantuar Raportin vjetor për vitin 2014 dhe për t'u përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Pasi që kemi marrë raportin nga KPMM-ja, unë kam kërkuar disa informata plotësuese që kanë të bëjnë me tantiema, me një krahasim të tantiemave tek ne dhe në vendet e tjera, gjithashtu edhe me një pasqyrë më të përmbledhur lidhur me të ardhurat nga renta minerare apo tantiema dhe të cilat i ka sjellë KPMM-ja. Ai shtoi se të pranishëm nga KPMM-ja, janë anëtarët e rinj të Bordit, të kryesuar nga z.Musa Shabani dhe ia dha fjalën për prezantimin e raportit.

Musa Shabani, kryesues i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) – KPMM-ja është institucion shumë i rëndësishëm, sa i përket sektorit gjeologjisë dhe minierave në Republikën e Kosovës, i cili është i lidhur direkt me zhvillimin ekonomik të vendit, krijimin e vendeve të punës, si dhe gjenerim të hyrave për buxhetin e Republikës të Kosovës. Duke parë urgjencën që KPMM-ja ka qenë pa Bord, atëherë ne si Bord i ri u mbledhëm më 8 maj 2015, organizuam takimin e parë, ku u informuam nga Ramiz Krasniqi, nga Bordi i kaluar në pika të përgjithshme për situatën aktuale dhe gjendja në KPMM. Duke parë se një situatë e tillë ishte mjaft akute-urgjente për sa i përket aplikacionit për licenca dhe leje të ndryshme minerare, ne e caktuam një agjendë të jashtëzakonshme për shqyrtim të aplikacioneve me prioritet, siç janë: Trepça, Ferronikeli dhe të gjitha kompanitë tjera. Njëkohësisht, përcaktuam në atë takim edhe për objektivat kryesore që mendojmë që në këtë të vit t'i realizojmë. Objektiva kryesore e parë është zbatimi i Ligjit për miniera dhe minerale; e dyta është shqyrtimi i gjitha lejeve dhe të licencave deri në pjesën e parë të qershorit, pra deri më 15 qershor, t'i përfundojmë të gjitha; e treta, si objektivi, është adresimi i përgjegjësive nga të gjeturat në raportin e auditorit të përgjithshëm për vitin 2014; e katërta është disiplinimi financiar i bizneseve që bie në kompetencat e Ligjit për miniera dhe minerale; dhe, e pesta, ngritja e performancës së institucionit të KPMM-së. Natyrisht se për t'i realizuar të gjitha këto objektiva, ka edhe sfida.

Pra, edhe ne si Bord, i kemi diskutuar sfidat të cilat jo që ne po përballohem për herë të parë, por KPMM-ja është përballuar në të kaluarën, janë operuesit ilegalë. Ne si Bord i ri kemi menduar se këtë sfidë ta zgjidhim duke hartuar një plan të përbashkët veprimi, për ndalimin e operuesve ilegalë, së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimin Hapësinor, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë. Sfidë tjetër që e kemi vërejtur është që në fillim është mjaft e rëndësishme për t'u adresuar dhe është problematika dhe shqetësimi i kompanive lidhur me Ligjin për miniera dhe minerale. Ka ankesa të kompanive për disa çështje problematike që paraqiten në këtë ligj. Ne, sot jemi këtu si Bord i ri që përbëhet nga: Festim Kutlllovci, Azem Rexhaj, Ramiz Krasniqi, nga mandati i kaluar, dhe Kemail Zeqiri që nuk është prezent. Brenda këtyre 5 ditësh pune që kemi bërë, kemi disa të arritura. Kemi mbajtur 5 takime të rregullta të Bordit, ku kemi shqyrtuar 30 aplikacione për licenca dhe leje, prej të cilave 22 janë aprovuar, ndër to me të rendësi të veçantë, siç janë licencat e Trepçës për Minierën e Artanës dhe Minierën e Stantërgut dhe për Ferronikelin. Ndërsa, sa i

përket raportit që do të trajtohet si objekt i kësaj pike të rendit të ditës, do të flasë anëtari me mandat tash nga mandati i kaluar i Bordit, z.Ramiz Krasniqi.

Ramiz Krasniqi KPMM – Shqyrtimi i licencave në vitin 2014, ka qenë përafërsisht 140. Me ardhjen e Bordit të ri, licencat kemi vendosur t'i shqyrtojmë me prioritet, siç kanë qenë ato që iu ka ndaluar puna, për shkak të mungesës së Bordit. Dy projekte kapitale që KPMM-ja i ka miratuar në vitin e kaluar, siç është Plani i menaxhimit të resurseve të Kosovës dhe një hartë me planshete gjeologjike, e cila është e punuar me propozimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës në Bjeshkët e Gjeravicës, për gjeoturizmin dhe resurset minerale që ka ajo zonë. Gjatë vitit 2014, janë realizuar 376 inspektime në terren, 225 prej atyre që kanë licenca valide, 23 licenca të hulumtimit, 87 të shfrytëzimit, 28 me komisione, 25 në miniera nëntokësore të Trepçës, Artanës dhe Bellopojës, etj. dhe 62 për aktivitete të veçanta. KPMM-ja ka shqiptuar disa gjoba për operuesit ilegalë, ndërsa këta operues duhet të jenë të informuar, që do të thotë nuk mund të ndërpriten vetëm me angazhimin e KPMM-së, ndërsa këtu kam vërejtje në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar, sepse nuk kanë bashkëpunuar me ne. Ndërsa, licenca aktive në fundit të vitit 2014 janë: licenca të hulumtimit 112, licenca të shfrytëzimit 119, d.m.th janë 302 licenca vetëm për hulumtim dhe shfrytëzim, kurse për makineri janë 115 licenca, prej tyre 75 operacione dhe 37 baza të betoneve. Buxheti i aprovuar në fillim të vitit 2014 ka qenë 1.758.600 euro. Në vitin 2013, inkasimi i të hyrave ka qenë 25.255.012 euro, ndërsa në vitin 2014, 26.966.931 euro, që do të thotë se ka pasur ndryshim për 1.711.919 euro, edhe pse nuk kemi dhënë licenca, vazhdimisht të hyrat kanë qenë në rritje.

Kryetari – Është me interes që të diskutohet për çështjet strategjike si ky institucion me rendësi, por edhe Kuvendi dhe Qeveria, të arrijnë të krijojnë një rregull që resurset e minierave dhe mineraleve, të mbrohen nga shfrytëzimi i egër, shfrytëzimi i papërgjegjshëm. Mirë që i diskutuat dy projektet, planin e menaxhimit të resurseve dhe planshet gjeologjike, sepse ato kanë rendësi dhe është mirë që t'i prezantoni në Komision, deri në mbledhjen e ardhshme, që t'i shohim se deri ku janë. Çështje me rendësi është kadastra minerare. Ju lutem, të jepni një vlerësim se sa e kemi të kompletuar kadastrën minerare në Kosovë, në përgjithësi, si dhe nivelin e hulumtimit të burimeve minerare në Kosovë. Çështja e tantimës apo rentës minerare, po shihet se i kemi prej taksave minerare, taksave administrative 26.9 milionë, përafërsisht 22 milionë euro janë nga KEK-u, që do të thotë se ne jemi koncentruar në KEK, por në pjesën tjetër nuk e kemi rregulluar mirë dhe nuk jemi duke e menaxhuar mirë këtë situatë, ndoshta duhet një sqarim më i madh i kësaj pune. Gjithashtu, duhet të bëhet një analizë e përvojave të tantimave, rentën minerare në Kosovë dhe vendeve tjera. Ne do të kërkojmë sigurisht debat të posaçëm për këtë punë dhe do të shohim politikat e rentave minerare në Kosovë dhe vendeve tjera, si dhe të shohim se ku jemi ne. Unë nuk e kam pritur që të jetë kjo shumë kaq e madhe, por në qoftë se ka paguar KEK-u, minierat e Bardhit dhe Mirashit, aty që nxjerrin, atëherë sipas standardeve ndërkombëtare që nxirren një pjesë e konsiderueshme e këtyre mjeteve, duhet të shkojë sipas parimeve të komunitetit atje, por ju nuk jeni përgjegjës për atë punë, ne kemi punë me buxhetin e Qeverisë.

Besim Beqaj – Si raport, është i mirë se i ka adresuar gjërat shumë qartë, por ajo çka më bën përshtypje, është përdorimi i paautorizuar i resurseve minerare. Duke marrë parasysh se kemi një përdorim të fuqishëm dhe është prezent në treg, do të thotë nuk është shfrytëzim për nevoja individuale, por është edhe për nevoja komerciale, besoj se me këtë çështje do të merret edhe bashkëpunimi, siç e thatë edhe ju, në mes jush dhe institucioneve zbatuese të ligjit. Pra, ky përdorim i paautorizuar i resurseve minerare, i ka dy rreziqe, një është, sepse kemi përdorim të pakontrolluar dhe e dyta është se mund të jetë rrezik ekstrem i madh i shpërdoruesit se nuk kanë pajisje dhe nuk kanë instrumente të veçanta, të cilat janë të nevojshme. Po janë edhe dy çështje që mua më interesojnë, janë licenca për hulumtim dhe licenca për shfrytëzim, ku sipas informative që kemi, licenca për hulumtim shpesh edhe keqpërdoret. E di se keni limitime në kohë, por ato veprime duhet të pasohen me monitorime të drejtpërdrejta të zyrtarëve të KPMM-

së, se a janë duke hulumtuar që po bëjnë veprim apo jo. Pjesa që është e rëndësishme për investitorë, është koha e licencave për shfrytëzim. Këto konsiderohen se njëherë e kemi kohën e gjatë të licencave për hulumtim dhe pastaj koha për shfrytëzim është koha e cila duhet të shikohet mundësia që të zgjatet, sepse investimi është goxha i madh dhe kërkon mundësi financiare të ndërmarrjeve, për ta bërë atë investim. Pra, tentoni t'i shkurtoni licencat në hulumtuese, në afatin më të shkurtër dhe të monitorohen se a kanë kapacitet apo nuk kanë kapacitet, të shihet mundësia e zgjatjes së licencave, të cilat janë për shfrytëzim. Ndërsa, nga kuptimi i operatorëve ilegalë, këtu kërkohet angazhim i shpejtë.

Visar Ymeri – Pyeti për objektivat që janë paraqitur në raport në faqe 12: A janë këto objektiva për vitin e ardhshëm, pra për vitin 2015, pasi që po raportoni për vitin 2014, si dhe e dyta, si mendoni t'i arrini këto objektiva? Në anën tjetër, kur flasim për operimet ilegale, mendoj se do të ishte mirë që në raport të bëni një zbrëthim në atë nëse operimet ilegale ose çka konsiderohen operime ilegale dhe a janë vetëm personat juridikë apo edhe ata fizikë, të cilët përdorin mineralet e Kosovës, pa qenë të licencuar apo ka një shpërputhje në mes të licencës ose planifikimit të asaj që është lejuar nga KPMM-ja dhe në anën tjetër shfrytëzimit. Tek thëngjilli, është hera e parë që planifikimi ka qenë më i madh sesa realizimi. Këtu mbase ka të bëjë me avarinë në Kosovën A. Por, në rastet tjera, kemi një shpërputhje shumë të madhe, p.sh. tek kromi, realizimi për vitin 2014 ka qenë vetëm 27%, 10 mijë tonë kanë qenë të planifikuara, 2700 tonë të realizuara, siç është raportuar nga ndërmarrja. Në vitin 2013, e kemi një realizim shumë më të madh, 62.01 %, pastaj në vitin 2012 e kemi një realizim shumë të ulët 20%, ku kjo duket shumë e dyshimtë nga ajo që është raportuar dhe nga ajo që është planifikuar nga ndërmarrja dhe që është realizuar. E njëjta gjë edhe tek Ferronikeli, që ka një luhatje shumë të madhe në realizim e që më duket se është problem i madh për afarizmin e tyre, nëse kanë dallime në mes të planifikimit dhe realizimit të tyre. A ka dyshime këtu dhe a keni bërë ndonjë inspektim, vlerësim të asaj që mundësisht këto kopani nuk po raportojnë realizimin aq sa e kanë arritur? Pastaj tjetra është se këto licencat për hulumtim, ne e dimë që në disa raste, licenca për hulumtim është shfrytëzuar si licencë për shfrytëzim. Pra, ata e kanë pasur licencën për hulumtim dhe kanë shfrytëzuar resurse minerale të Kosovës dhe nuk i kanë raportuar si të tilla. Kërkoj nga KPMM-ja të na informojë se ku qëndron problemi tek këto paqartësi, shpërputhje kaq të mëdha që i keni raportuar.

Sala Berisha – Shala – Faqja 12 e raportit, tek përmbledhja ekzekutive, e keni paraqitur realizimin e projekteve kapitale, siç është përpilimi i hartës gjeologjike, 1 me 25 mijë dhe përpilimi i planit të menaxhimit të resurseve. Ju njoftoj se sipas Ligjit për miniera dhe minerale kjo veprimtari është dashur t'i kalohet Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe është dashur si dy institucione, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, përkatësisht Shërbimi Gjeologjik i Kosovës dhe KPMM-ja t'i transferojnë ato projekte. Pyeti: Pse nuk janë transferuar këto projekte? Pyetje tjetër tek objektivat, e keni përmendur rritjen e investimeve të huaja, që sipas jush, keni menduar që investimet e huaja në këtë sektor do të rriten përmes pjesëmarrjes dhe organizimit të referencave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kjo është shumë e rëndësishme, për shkak të sensibilizimit të opinionit të investitorëve që janë të interesuar të investojnë në industrinë minerare, por unë mendoj që menjëherë pranë kësaj është e rëndësishme të ketë një plotësim apo ndryshim të ligjit. Në faqen 63, si sfidë e keni paraqitur edhe mosfunksionimin e laboratorit gjeologjik ose keni thënë moszbatimi i marrëveshjes nga instituti. Mendoj se këto shkojnë bashkërisht dhe paralel, transferimi i projekteve në Shërbimin Gjeologjik, licencat për hulumtim, kohëzgjatja e licencave, duhet të shkurtohet afati, në mënyrë që të mos bllokohet resursi. Në qoftë se ai kërkon licencë dhe është i licencuar, nuk e zhvillon më tutje aktivitetin e tij, d.m.th. nuk kalon në shfrytëzim të këtij minerali, mirëpo ka dalë problem tjetër. Pra, ju duhet të bëni një hulumtim dhe të bëni dallimin se për cilat minerale të ketë licencë, që licenca të jetë më afatshkurtër, e për cilat nevojitet të jetë afati i gjatë, bie fjala për mineralet metalore duhet një licencë afatgjatë, sepse investimet janë më të kushtueshme dhe duhet kohë më e gjatë. Nuk duhet të kufizohet vetëm me sipërfaqe që është e kufizuar, pastaj me vazhdimin e licencës të shkurtohet 50% sipërfaqja d.m.th

është vërejtur që është një pengesë për investim të mëtutjeshëm. Në fund, porositi se nëse KPMM-ja e sheh ndonjë pengesë në drejtimin lidhur me tantimet, e inicioni këtë ndryshim, pra të vlerës së tantimeve.

Blerim Grainca – Do të doja të ndalem tek disa çështje që lidhen me punët operationale ditore. Për mua është e rëndësishë së veçantë çështja e dhënies së licencave, që është përmendur këtu. Pyeti: A e kanë arritur objektivin, a e ka arritur qëllimin dhënia e licencave? Nëse i referohemi raportit, shihet se kemi 77 paraqitje penale që i keni bërë dhe këto 77 paraqitje, më intereson të di, a janë paraqitje për mospagesë të tantimës apo janë për shfrytëzim ilegal, ku është dallimi? Dhe, po ashtu, tek kjo kam parë se keni 15 milionë borxhe të paarkëtuara. Unë dua ta shihja në mënyrë pozitive punën e KPMM-së dhe mendoj se kjo vlerë na duket e madhe, por do të na shpjegoni se ku është arsyeja, pse janë këto borxhe të grumbulluara dhe këto 77 paraqitje penale a janë në procedurë? Pse nuk po ekzekutohen? A është çështja e mos- funksionimit të gjyqësorit, apo janë çështje që lidhen me punët operationale të vetë KPMM-së apo është mungesë e koordinimit e institucioneve të tjera? Po ashtu, unë si deputet kam marrë një numër të ankesave të qytetarëve gjatë muajit të kaluar, që lidhen konkretisht me dhënien e licencave. Thuhet se janë dëmtuar resurset tjera apo pasuritë tjera natyrore, siç është rasti i shpellës së Gadimes, ku thuhet se si rezultat i hulumtimeve dhe operimit të operatorëve që lidhen me gurëthyes, si dhe çështje tjera, ka ardhur deri te dëmtimi i shpellës, e cila ka filluar që të thahet, prandaj këtë çështje mendoj se duhet ta shikoni në të ardhmen e afërt se a është kjo e vërtetë. A e keni nisur harmonizimin në mes ligjeve që është vërejtur se ka diskrepancë në mes Ligjit për miniera dhe Ligjit për pyjet, pse është kjo diskrepancë? Si dhe vitet dhe afatet e licencave, a janë që janë paraparë në këtë ligj? A janë pengesë për investitorët dhe janë të mjaftueshme si afate kohore?

Raif Qela – Sa i përket raportit të KPMM-së, u pajtuan të gjithë parafolësit e mi se ka një strukturë që është në përputhje me manualin për raportimin e institucioneve dhe agjencive të pavarura, dhe si i tillë, mendoj se duhet ta miratojmë, sepse është i gjithanshëm dhe ofron të dhëna të mjaftueshme lidhur me punën e këtij institucioni gjatë vitit 2014. Do të isha ndalur në veçanti vetëm tek një çështje, ku u tha se njëra prej hallkave ndërmjet KPMM-së dhe institucioneve tjera, po mungon dhe do të doja të dija se cila është ajo hallkë. Cilat janë ato pengesa? Është përmendur këtu Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar, dhe nëse nuk ka bashkëpunim nëpërmjet tyre, të na i tregojnë hollësitë, në mënyrë që të kërkojmë rrugëzgjdhje, që të mos keni pengesa në punën tuaj.

Enver Hoti – Në raport janë prezantuar 75 raste të veprimtarive ilegale. Pyeti: Kush janë ata njerëz dhe a kanë mundur që të jenë pjesë e këtij raporti? Ku është gjeografikisht ndonjë terren ku ushtrohet kjo veprimtari ilegale për shfrytëzimin e resurseve minerare, në cilën pjesë dhe cilat janë ato minerare që më tepër goditën në këtë formë ilegale? Pastaj një shqetësim i veçantë është mosbashkëpunimi me Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar, pse mendoni se ndodh kjo? Ata nuk i përfillin kërkesat e juaja në këtë drejtim, ku qëndron arsyeja? Pastaj në raportin e Komisionit për Rregullim të Prokurimit Publik është raportuar se, njësia “Trepça” në pjesën veriore, nuk e ka raportuar raportin e saj kontraktues, a keni ndonjë të dhënë për raportet kontraktuese të njësisë dhe aktiviteteve që zhvillon pjesa veriore njësia “Trepça”. Kërkoj që raporti të japë të dhëna shumë më të mëdha lidhur me atë se a nxjerrën këto resurse në formë ilegale edhe jashtë vendit, a keni të dhëna?

Pal Lekaj – Sa i përket raportit fiskal të vitit 2014, mendoj se ka mjaft material që diskutohet, mirëpo përpos asaj që u tha këtu, mendoj se janë me rëndësi për vendin tonë dy komponentë: e para, zhvillimi ekonomik i vendit, dhe dy, mbrojtja e ambientit. Nëse nisemi nga ajo që deri më tani është vepruar në tërë hapësirën e Kosovës, mendoj se kemi mjaft operatorë ilegale që i keni përmendur e që nuk kemi ndërhyrë efektshëm. Deri më sot, janë një numër i vogël i atyre që janë gjobitur apo që iu ka konfiskuar materiali, teknologjia. U përmend edhe “Trepça” dhe jemi të

shqetësuar për veriun, sepse kemi informacione se nuk ka ndonjë komunikim apo monitorim të Bordit dhe të Qeverisë së Kosovës dhe këtu duhet që të jeni prapë të vendosur, meqë është në territorin e Kosovës, vepron në territorin e Kosovës, të jeni më të qëndrueshëm dhe më efikas, pas kompletimit Bordit.

Kryetari – Keni përmendur çështjen e shqetësimeve ilegale, por nuk është elaboruar sa duhet ky problem. Pra, na nevojitet edhe në Kuvend që të shihet se kush janë këta, në cilat rajone, çka keni ndërmarrë dhe ku janë pengesat që ky problem të adresohet me kujdes. Sepse, po shihet se i keni disa gjoba, 84 gjoba dhe i keni 77 paditje, por duhet një elaborim më i madh, në mënyrë që edhe ne t'i rekomandojmë Kuvendit se çfarë bëhet dhe organeve përkatëse që duhet të punojmë bashkë me juve, që kjo praktikë të tejkalohet.

Ramiz Krasniqi, KPMM – Po filloj nga kryetari, që pyeti se si të krijohet një strategji për zhvillim të qëndrueshëm. Ministria për Zhvillim Ekonomik ka shpallur 11 zona të interesit, të cilat janë zona më të hulumtuara në Republikën e Kosovës, kur e them këtë, kam argumente dhe që lidhet edhe me pyetjen që ma ke bërë për nivelin e hulumtimeve në Kosovë dhe kadastrën minerale. Për fat të mirë, KPMM-ja ka arkivin gjeologjik të të gjitha hulumtimeve në Kosovë, prej Luftës së Dytë Botërore, deri më tani. KPMM-ja e ka një bazë të të dhënave. Ju lutem, sipas Ligjit për miniera dhe minerale, KPMM-ja nuk ka të drejtë t'i shpallë ato zona të interesit për publikun dhe për investitorët e huaj. Sipas ligjit, ato shpallen me partneritet publiko-privat. Qeveria, d.m.th. edhe ne, ju propozojmë që menjëherë të fillojmë që ato zona t'i shpallin në partneritet publiko-privat. Ne do të jemi mbështetës i juaj në çdo kohë, në dhënien e informacioneve për ato zona. Aeroincizimi apo incizimi gjeofizik ajror është kryer në vitin 2006-2007, ku KPMM-ja posedon edhe incizimin gjeofizik ajror, që nuk e kanë edhe disa shtete të tjera. Tantiema 21 milionë është nga KEK-u. Është e vërtetë se në vitin e ardhshëm parashihet të shkojë në 24 milionë, sepse ata realisht kanë pasur disa avari, se përndryshe i shfrytëzojnë 8 milionë brenda vitit për furnizim normal me energji elektrike, por për shkak problemeve që i kanë pasur, i kanë shfrytëzuar vetëm 7 milionë. Taksat janë për aplikacion, d.m.th dallojnë. Kështu, për minerale metalike është 1000 euro aplikacioni, për minerale ndërtimore është 200 euro, që nuk janë të mëdha, për mbajtje të licencës vjetore për minerale metalike është 1400 euro, për mbajtje të licencës për shfrytëzim është 500 euro, po ashtu edhe për baza të betonit është 500 euro. Pyetja që e parashtruat për operimet ilegale, ku në shtojca të raportit keni të gjithë operuesit ilegalë, me emër e mbiemër d.m.th ata operojnë ilegalisht, por nuk janë të panjohur për publikun, sepse ne e kemi obligim ligjor t'i identifikojmë, pra ne i kemi identifikuar. Kur kemi filluar me sekuestrimin sipas Ligjit të minierave, inspektorët e minierave dhe mineraleve kanë për obligim. Ne nuk i ikim përgjegjësisë për të sekuestruar, por nuk na ka mbështetur Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë. Ne kemi pasur inspektorë të kërcënuar, kemi pasur inspektorë të rrahur, sepse nuk munden që inspektorët tanë, të bëhen policë, se ata i sulmojnë fizikisht dhe këta nuk na kanë dalë kurrë në ndihmë, për çfarë arsye, ne nuk e dimë. Me policinë kemi pasur një bashkëpunim të mirë, po ashtu edhe me komuna ka filluar të përmirësohet bashkëpunimi, sidomos në rajonin e Dukagjinit. Sa i përket borxheve të KPMM-së, të gjitha i keni me emër dhe mbiemër në raport. Pyetja nga Pal Lekaj se "Trepça" në veri, nuk ka komunikim - kjo informatë nuk është e saktë, sepse KPMM-ja prej themelimit ka bashkëpunim me minierat e Trepçës edhe ne veri. Ata kanë licenca në KPMM dhe raportojnë çdo tre muaj. Pyetja licenca për hulumtime të metaleve, gjobat e të hyrat janë të vogla, janë të vogla, sepse ne nuk mund t'i marrim paratë, por gjykata vendos.

Besim Beqaj – Unë thashë, nuk duhet fokusuar në gjoba, por duhet një parandalim. Nuk kam kërkuar që të rriten të hyrat me gjoba.

Ramiz Krasniqi, KPMM – Ne, në parim, nuk jemi për ta dënuar askënd. Ne i udhëzojmë kompanitë që të vijnë dhe të licencohen dhe ua caktojmë një afat, një vërejtje brenda një muaj,

shikohet se a po e ndërprejnë punën apo jo, nëse nuk licencohet brenda muajit, i bëhet raporti dhe i shkon lënda në gjykatë. Lidhur me licenca për hulumtim për afat-licenca për hulumtim të jo-metaleve, kanë afat sipas Ligjit për miniera dhe minerale 25 vite, por ata e paraqesin një dinamikë, nëse ai e do për 5 vite, ne nuk mund t'i japim më shumë, sepse ai nuk ka rezerva. Në bazë të rezervave, paraqesin edhe dinamikën e shfrytëzimit. Licenca për metale sipas Ligjit për miniera dhe minerale kanë 30 vite, me mundësi vazhdimi. Lidhur me objektivat për të ardhmen – objektivi kryesor për të ardhmen është parandalimi i operuesve ilegalë, d.m.th kjo është sfida më e madhe e jona. Lidhur me bashkëpunimin me institucionet, ne realisht kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë me Ministrinë e Mjedisit. Rreth raportimit, të gjitha kompanitë që e shohim që nuk po raportojnë në raport lidhur me shfrytëzimin, për këtë kemi 26 raporte me komisione d.m.th. dalim me komision edhe i vërtetojmë. Pyetja për përpilimin e plantës, ne e kemi lutur edhe Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, merrni këto baza të betonit dhe të asfaltit, por nuk i ka marrë askush. Po ashtu, e kemi lutur Shërbimin Gjeologjik dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, me ligj iu takon projekteve kapitale të tyre. Kemi probleme me zbatimin e Ligjit për pyje. Është një ligj që duhet të amendamentohet, sepse po na krijon shumë probleme, për shkak të lejes që e lëshon Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë. Lidhur me laboratorin gjeologjikë, ne e kemi bërë një memorandum bashkëpunimi me Shërbimin Gjeologjik. E kemi pasur një laborator dhe nuk na duhet më neve, se është konflikt interesi. Licencat në funksion të shfrytëzimit, sa e kanë arritur qëllimin, shumica e kanë arritur qëllimin, por ka edhe që nuk e kanë arritur. Lidhur me shpellën e Gadimes, është problem i mëhershëm. KPMM-ja ka kërkuar nga ato kompani, pëlqime mjedisore. I kanë kërkuar dokumentacionet e nevojshme për licenca. Ne çka kemi pasur mundësi, kemi bërë.

Sala Berisha – Shala – Nuk është se nuk kanë staf Shërbimi Gjeologjik i Kosovës. Edhe me ligj, KPMM-ja ka qenë e obliguar ta dorëzojë edhe arkivin edhe data bazën e gjeologjisë, madje edhe një pjesë të stafit që është i panevojshëm për të qëndruar. KPMM-ja duhet të jetë pjesë e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës. Ata ballafaqohen me mungesë të hapësirës.

Pal Lekaj – Sa i përket asaj që iu referuat pyetjes sime, unë jam nisur nga raporti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me pjesën veriore të operimit të Trepçës dhe është mirë që ju keni qasje për licencim. Ndërsa, sa i përket asaj se a zbatohet një rregullore dhe një vendim, sa i përket zhavorrit në lumenj, shumë pak po zbatohet në terren.

Blerim Grainca – Përgjigjja për borxhet e paarkëtuara, ju iu referuat asaj se janë shumë borxhe të Trepçës. Nga raporti juaj, janë 15 milionë borxhe të paarkëtuara, kurse vetëm 3 milionë, janë të Trepçës. Çështja tek borxhet e tjera është se a ka raste që kompanitë i kanë detyrime agjencisë tuaj dhe ju ka vazhduar licenca apo aplikojnë për licenca tjera? A ju kushtëzohet dhënia e licencave dhe vazhdimi me borxhe? A i vazhdohet apo a mund t'i merret licenca? A janë selektive? A ka raste kur një kompanie i lejohet dhe tjetrës nuk i lejohet? Duhet të keni një qasje më serioze sa i përket shpellës së Gadimes.

Raif Qela – Edhe në raport është pasqyruar se shfrytëzimi i pasurive minerare ka rënë nga Ferronikeli. Mendoj se arsyeja kryesore është se një pjesë të pasurive minerare, ajo e importon. Edhe kjo është në sasi të konsiderueshme, pikërisht për këtë shkak është pasqyruar edhe në raport dhe kjo është arsyeja e vërtetë.

Ramiz Krasniqi KPMM – Përgjigjja për borxhe, asnjë kompani nuk mund të licencohet, pa i kryer obligimet sipas ligjit.

Kryetari – Së bashku me komisionin, ndaj mendimin e njëjtë se ky është një sektor shumë i rëndësishëm. Përgjegjësia e Bordit është e madhe, ku së bashku me Qeverinë, të vëmë bazat e një zhvillimi të qëndrueshëm të pasurive minerare të Kosovës, në dobi, në interes më të madh publik,

në interes të investitorëve dhe në interes të komunitetit. Për shpellën e Gadimes, nëse e kanë alarmuar gjendjen, ju duhet të shënoni një raport shtesë dhe së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe me komunën, të shkoni dhe të shikoni se sa është e rrezikshme gjendja atje. Neve nuk na interesojnë emrat e operuesve ilegalë, por neve si komision na intereson problemi, na intereson fenomeni. Neve na intereson se sa individë janë, sa ndërmarrje, sa kanë bërë veprime ilegale, cilat masa i ka marrë KPMM-ja. Pra, të ceket në raport shtesë, nëse ia keni tërhequr vërejtjen, por kanë vazhduar prapë të veprojnë në mënyrë ilegale, prandaj kërkojmë nga ju që këtë çështje ta shënoni në mënyrë më serioze dhe më të detajuar. Lidhur me kompetencat në mes juve dhe ministrisë, këtu nuk guxojmë të kemi gjëra të paqarta, sepse kompetencat duhet të zbatohen siç janë me ligj.

Pas debatit, Komisioni vendosi

R e k o m a n d i m

I. Të miratohet Raporti vjetor i punës së Komisionit për Miniera dhe Minerale për vitin 2014, me plotësime shtesë dhe Rekomandimet si në vijim:

1. Të vazhdojë angazhimi në azhurnimin e katalogut mbi burimet minerare të Kosovës, si dhe sigurimin e të gjitha parakushteve për certifikimin e rezervave minerare të Kosovës.
2. Të plotësohet raporti lidhur me shfrytëzimet ilegale të mineraleve, në aspektin e strukturës së tyre, lokacioneve të tyre, sektorët ku janë prezentë, si dhe masat që duhet të ndërmerren për të parandaluar vazhdimin e shfrytëzimit ilegal të mineraleve, edhe pas vendimeve të KPMM-së për të ndërprerë këto veprime.
3. Në mënyrë urgjente të themelohet një komision i përzier nga KPMM-ja, me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Lipjanit, për të konstatuar shkallën e rrezikimit eventual të Shpellës së Gadimes, nga eksploatimi i gurëve dhe marrjen e masave përkatëse mbrojtëse.
4. Të ndërmerren masa për inkasimin e borxhit që kanë operatorët ndaj KPMM-së në shumën prej 15 milionë eurosh.
5. KPMM-ja, të përgatitë dhe t’ia dorëzojë Komisionit një analizë krahasuese për politikën e rentës minerare në Kosovë, rajon dhe vendet që shfrytëzojnë minerale të ngjashme me Kosovën.
6. Obligohen, KPMM-ja dhe Ministria e Zhvillimi Ekonomik, që të koordinojnë punët lidhur me realizimin e transferimit të kompetencave dhe stafit, nga KPMM-ja në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, sipas ligjit.

II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

4. Shqyrtimi i petitionit të Sindikatës së hotelit “Grand” bazuar në Përfundimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, të datës 22.04.2015

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa – Lidhur me këtë pikë, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, e ka shqyrtuar petitionin e Sindikatës së Hotelit “Grand” dhe në bazë të rekomandimit ka vlerësuar se kjo çështje është në fushëveprimin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Lidhur me këtë petition të Sindikatës së Hotelit “Grand”, kemi pranuar edhe një

njoftim me shkrim nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Andaj, është i ftuar z. Avni Jashari, përfaqësues nga AKP-ja, të cilit ia jap fjalën për të sqaruar çështjen e NSH të hotelit “Grand”.

Avni Jashari, UD i zv. drejtorit menaxhues në AKP – Në cilësinë e ushtruesit të detyrës së zëvendësdrejtorit të AKP-së, lidhur me peticionin e Sindikatës së hotelit “Grand”, kemi raportuar edhe në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione. Lidhur me çështjen e ndërmarrjes shoqërore të hotelit “Grand” është vepruar në bazë të ligjit, ku në bazë të rregullave, në datën e vendosjes së ndërmarrjes në likuidim, kontratat e punëtorëve ndërpriten automatikisht në mesnatë. Lidhur me çështjen e pagave, ai tha se me kërkesën e tyre, punëtorëve u janë paguar edhe pagat e muajit janar 2015, d.m.th. para se ndërmarrja të vendosej në likuidim, ndërsa pasi që ndërmarrja të vendoset në likuidim, nuk kemi obligim për ata, sepse kontratat e tyre shkëputen automatikisht. Vendimin për vendosjen e hotelit “Grand” në likuidim e ka marrë Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e gushtit të vitit 2014, në përbërje të plotë. Hoteli “Grand” është shitur një herë në vitin 2005, janë tërhequr aksionet në vitin 2012. Sipas ligjit, tani llogaritet ndërmarrje në likuidim dhe kjo do të shitet kur të kompletohet Bordi i ri i drejtorëve. Agjencia, edhe pse ka bërë planin për vitin 2015, nuk i ka vendosur ende në shpallje në tender shitjen e ndërmarrjeve shoqërore, sepse duhet të kompletohet Bordi i Drejtorëve. Në fund, tha se deri sa nuk privatizohet hoteli “Grand” nuk do t’ju shkëputen kontratat punëtorëve, pasi që rrogat do t’i sigurojnë duke dhënë disa pjesë të hotelit me qira.

Pal Lekaj – Edhe pse është në likuidim NSH Hotel “Grand”, duhet të keni mirëkuptim ndaj punëtorëve dhe të mbahet si aset Grandi, dhe me zgjedhjen e Bordit të ri, të kemi shumë kujdes lidhur me trajtimin e kësaj ndërmarrjeje, por punëtorët duhet të mbahen e mos të lihen në rrugë.

Pas debatit, Komisioni konstatoi se do të njoftohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, se masat e marra nga AKP-ja kanë qenë të imponuara nga normat ligjore dhe gjithashtu konstatohet se Autoriteti i Likuidimit iu ka dhënë kontrata të gjithë punëtorëve që kanë qenë në punë. Komisioni kërkoi nga AKP-ja dhe Autoriteti i Likuidimit, që në kuadër të zhvillimit të procedurave përkatëse të likuidimit, të mbahen gjallë aktivitetet ekonomike dhe shërbimet e kësaj organizate, në mënyrë që punëtorët të marrin paga.

5. Të ndryshme

Caktimi i ekspertëve për projektligje

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa – I njoftoj anëtarët e Komisionit se do të caktojmë ekspertët për projektligjet në procedurë, si për Projektligjin për digjitalizim dhe për nismën legjislative- siguria në punë në miniera. Për Projektligjin për dixhitalizmin kemi tre ekspertë dhe duhet të zgjedhim njërin, të cilët janë: Azem Kastrati, Valon Grabanica dhe Atif Bashani. Më sa duket, në bazë të CV-së, më i përgatituri është i dyti me radhë, z.Valon Grabanica, sepse edhe paska punuar më herët në ARKEP dhe e ka përvojën që duhet dhe hapi debat.

Fatmir Rexhepi – Në bazë të dhënave, më i përgatitur duket se është i pari me radhë, z.Azem Kastrati, sepse është inxhinier i teknologjisë informative dhe paska eksperiencën e duhur.

Raif Qela – Nuk duhet të ngutemi, sepse është çështje e ndejshme dhe është dashur ndoshta të marrim një mendim edhe nga Komisioni për Media, sepse edhe ata janë pjesë e grupit të punës dhe kërkoj më shumë kohë. Po ashtu, e propozoj që të kontaktohet edhe z.Ismet Hamiti, duke marrë parasysh përvojën e tij në ITU.

Visar Ymeri – E përkrahu z.Qela dhe tha se për shkak të ndjeshmërisë së fushës që e rregullon ky projektligj, duhet të kemi më shumë kohë dhe të merret një ekspert i mirë.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-27 për digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, më së largu, deri në mbledhjen e radhës, të përcaktohet për caktimin e ekspertit për shqyrtimin e këtij projektligji.

Sala Berisha – Shala – Lidhur me caktimin e ekspertit për nismën legislative, kemi pasur tre ekspertë të propozuar: Izet Shehun, Hamit Nuredinin dhe Jahir Gashin. Por, grupi i punës është pajtuar që prof. dr. Izet Shehu, të caktohet si ekspert i jashtëm për nismën legislative për sigurinë në punë në miniera, si më të përgatiturin për këtë fushë.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

V E N D I M

- 1. Prof. dr. Izet Shehu, caktohet ekspert i jashtëm për nismën legislative për sigurinë në punë në miniera.*
- 2. Ngarkohet grupi punues dhe koordinatori i Komisionit, që brenda tri ditësh pune të përgatisin termat e referencës, ku definojnë përgjegjësitë e ekspertit, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa